



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër: 463-01/11421, dt: 28 Shkurt 2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve privat Jeton (Rexhep) Bala, Edison (Rexhep) Bala, Bahrije (Nazmi) Bala dhe Murat (Emin) Balaj, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 28 Shkurt 2025, mori këtë:

VENDIM

Nr. 05/2025

Mbi Miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Jeton (Rexhep) Bala, Edison (Rexhep) Bala, Bahrije (Nazmi) Bala dhe Murat (Emin) Balaj me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit - shetitore dhe hapësirë e hapur publike si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit - shetitore dhe hapësirë e hapur publike, si Interes Publik sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Parcela kadastrale nr.2301-2 me sipërfaqe 20m² ZK Pejë në pronësi të Murat (Emin) Balaj si dhe parcelat kadastrale me numër 2301-3 me sipërfaqe 14m² ZK Pejë dhe 2301-1 me sipërfaqe 50m² në pronësi të Jeton (Rexhep) Bala me 1/3, Edison (Rexhep) Bala me 1/3 dhe Bahrije (Nazmi) Bala me 1/3 do të merren me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit - shetitore dhe hapësirë e hapur publike, si Interes Publik sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jenë objekt këmbimi me ngastren kadastrale nr.6333-2 në sipërfaqe prej 35m² ZK Pejë pronë **Komuna e Pejës**.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë të aprovuara me datën 06.02.2025.

-Prona e Komunës, ngastra kadastrale nr.6333-2 në sipërfaqe prej 35m² ZK Pejë është vlerësuar 750.00 €/m², përkatësisht totali 26,250.00 €

-Prona private e pronarëve privat Jeton (Rexhep) Bala, Edison (Rexhep) Bala, Bahrije (Nazmi) Bala, ngastrat kadastrale 2301-3 në sipërfaqe prej 14m² ZK Pejë dhe 2301-1 në sipërfaqe prej 50m² ZK Pejë si dhe prona private e Murat (Emin) Balaj nr.2301-2 në sipërfaqe prej 20m² ZK Pejë janë vlerësuar 420€/m², përkatësisht totali 35,280.00 €

Andaj obligohet Komuna e Pejës që të paguaj diferencën në shumën prej 9,030.00 € Jeton (Rexhep) Balës, Edison (Rexhep) Balës, Bahrije (Nazmi) Balës dhe Murat (Emin) Balës bazuar në Vlerësimin e bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë.

- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do ti nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike.
- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

*MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.*

